

Programi i Performancës dhe Investimeve në Sektorin e Ujit - Programi i Infrastrukturës Bashkiake V, Shërbime Konsulente - Konsulent Institucional

Duration: 25.01.2023 - 24.01.2028

Countries:
Albania

EU contribution: € 43 400 000

Total budget: € 145 700 000

Implementer:
SWECO, MACS, SETEC

Website(s): www.wpip-mipv.al



Social media:

facebook.com/CoPLANTirana,
instagram.com/coplanalbania/, facebook.com/KomunaJunik,
facebook.com/mirditebashkia, www.bashkiamirdite.gov.al,
<https://junik.rks-gov.net/>, co-plan.org/, <https://wpip-mipv.al/documentsdownloads/>

Project description:

Konsulenti Institucional mbështet në mënyrë të përgjithshme zbatimin e Programit WPIP/MIP V përmes masave që përforcojnë kapacitetet institucionale të AKUK. Ai e mbështet atë edhe përmes përgatitjes dhe përmbledhjes së raporteve të ndryshme të Konsulentëve të Zbatimit nga të gjashtë UKR-të, ku po zbatohen masat investuese. Planet e Biznesit për UKR-të dhe përditësimet e tyre vjetore gjatë periudhës së projektit përbëjnë një mjet të rëndësishëm për të përmbledhur, paraqitur dhe analizuar të gjitha masat mbështetëse të ofruara për gjashtë UKR-të dhe për t'i mundësuar AKUK, në këtë mënyrë, të kuptojë, monitorojë dhe vlerësojë zhvillimin e shoqërive të tyre të reja rajonale, si dhe të marrë vendime të informuara menaxheriale për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmërisë së UKR-ve.

Masat mbështetëse të ofruara nga Konsulentët e Zbatimit kontribuojnë në përmirësimin dhe sigurimin e aksesit të përbalueshëm të popullsisë në zonat e programit në furnizim të sigurt me ujë të pijshëm, shërbime kanalizimi dhe rritje të trajtimit të centralizuar të ujërave të ndotura të mbledhura.

Gjashtë Konsulentët e Zbatimit ofrojnë asistencën dhe shërbimet e mëposhtme:

- ☐ Studime Fizibiliteti
- ☐ Raporte të Projektimit të Detajuar
- ☐ Procesin e Tenderit

Expected results:

- ☐ Lidhur me qëndrueshmërinë: a) 100% mbulim i Kostove Operacionale të Drejtpërdrejta; b) reduktim i humbjeve të ujit; c) plane të përshtatura tarifore; d) faturim i përmirësuar; e) normë arkëtimi në mënyrë të qëndrueshme mbi 85%; f) përmirësim i verifikuar i qeverisjes së mirë;
- ☐ Lidhur me ujërat e shiut: 30,000 persona me reziliencë të rritur ndaj incidenteve nga ujërat e shiut në Lezhë.
- ☐ Lidhur me ujërat e ndotura: 152,000 banorë të lidhur në mënyrë efektive me sistemet funksionale të mbledhjes së ujërave të ndotura dhe trajtimit të centralizuar, të monitoruar në përputhje me direktivat e BE-së.
- ☐ Lidhur me ujin e pijshëm: rritje e numrit të popullsisë së lidhur në mënyrë efektive me rrjetin e përmirësuar dhe/ose të ri të furnizimit me ujë të pijshëm. Rritje e orëve mesatare ditore të furnizimit me ujë nga 13 në 16 orë.